



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31162-05885-80-2020 Data e Regjistrimit : 21/12/2020
Numri i Vendimit: 80-2021-2376 Data e Vendimit : 21/07/2021

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 21/07/2021mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore ceshtjen civile qe i perket :

Padites {...} I Paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale I Paditur {...}, shoqeri hollandeze

Objekti:1.Anullimi i vendimit nr. 480/13, date 20.05.2020 te Bordit te Apelimit dhe te vendimit nr. Prot 480/7, date 30.07.2019 te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve, prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale. 2.Detyrimin e Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale per anulimin e procedurave per rregjistrimin e markes {...} me numer aplikimi AL/T/2018/480 me pronar Bavari NV. 3.Detyrimin e Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale te kryej publikimin perkates ne kete rast ne Buletinin e Pronesise Industriale, per refuzimin e regjistrimitte markes ne favor te shoqerise "{...}". 4.Detyrimin e te paditurit "Bavaria" N.V. te nderprese aktivitetin e shperndarjes se produktit me marke tregtare {...}, per shkak te konkurences sc pandershme.

Baza Ligjore:Ligji nr. 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrevcshjeve administrative", i ndryshuar, Ligji nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikes se Shqiperise", Ligji nr. 9947, date 7.7.2008 "Per pronesine industriale", i ndryshuar. Vendim i Keshillit te Ministrave nr. 315, date 31.5.2018 "Per miratimin e rregul lores per markat".

VEREN :

Se paditesi shoqeria {...} sh.p.k ka paraqitur para kesaj gjykate kerkespadine me objekt: 1. Anullimi i vendimit nr. 480/13, date 20.05.2020 te Bordit te Apelimit dhe te vendimit nr. Prot 480/7, date 30.07.2019 te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve, prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale. 2. Detyrimin e Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale per anullimin e procedurave per rregjistrimin e markes {...} me numer aplikimi AL/T/2018/480 me pronar {...}. 3. Detyrimin e Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale te kryej publikimin perkates ne kete rast ne Buletinin e Pronesise Industriale, per refuzimin e regjistrimit te markes ne favor te shoqerise {...}.

Nga shqyrtimi gjyqesor ka rezultuar se, shoqeria {...} sh.p.k ka per objekt te veprimtarise se saj: Tregti me shumice e pakice artikuj ushqimore dhe industriale. Transport mallrash, etj. Tregtim me shumice e pakice marketing-distributor. Import-eksport, blerje-shitje i artikujve te ndryshem industrial, ushqimore, elektroshtepiake, kinkaleri, kozmetike, bime medicinale e mjekesore, mobileri, lende drusore, shfrytezim pyjesh, makineri e pajisje, pjese kembimi, materiale ndertimi, lende e pare, pajisje elektrike e elektronike, kancelari, pajisje hidrosanitare etj, tregtim i produkteve bujqesore e blegtorale, fruta-perime, prodhimin dhe perpunimin e tyre, tregtim me pakice i karburanteve vajrave e lubrifikanteve, prodhim, ambalazhim e perpunim e tregtim me shumice e pakice i ujit e te gjitha pijeve te tjera freskuese, alkoolike, jo alkoolike, energjike, etj.

Ne kuader te veprimtarise tregtare, shoqeria {...} sh.p.k ka regjistruar marken me nr. Regjistrimi kombetar 11992, e regjistruar per mallra te klases 32 te klasifikimit te Nices, konkretisht "Pije jo- alkoolike, pije energjike, pije sportive".

Ndersa shoqeria {...} (tashme shoqeria {...}) ka paraqitur prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industrial, kerkesen me numer AL/T/2018/480 per regjistrimin e markes {...}. Kjo kerkese eshte depozituar ne Drejtorine e Pergjithshme te Pronesise Industriale ne date 17.05.2018, dhe eshte publikuar ne Buletinin e Pronesise Industriale ne date 8.10.2018.

Ne date 25.01.2018, shoqeria {...} sh.p.k ka depozituar prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, kerkesen per kundershtimin e regjistrimit te markes me nr. Regjistrimi AL/T/2018/480, permes se ciles, ne menyre te permbledhur, ka pretenduar se:

Aplikimi per regjistrimin e markes {...} ka qartesi vizive dhe konceptuale, me marken tashme te regjistruar B52 me nr. Regjistrimi 11992, me pronar {...};

Aplikimi per regjistrimin e markes {...} ka ngjashmeri te plote/identike me aplikimet AL-T-2015/258; ALT-2011/752; ALT-T-2018/66; aplikimi nderkombetar me nr.1082916 me pronar {...}; Aplikimi AL-T2015/258 eshte kundershtuar nga {...}, ndersa aplikimi nr.1082916 dhe nr. 97087078 jane cregjistruar bazuar ne vendimet gjyqesore te perfunduara deri ne Gjykatën e Larte; B-52 eshte nje marke e njohur ne tregun shqiptar si produkt i {...}, i cili ka fituar procesin gjyqesor per cregjistrimin e aplikimeve te {...}, respektivisht per B-52 me nr.970878 dhe nr.1082916 dhe anullimin e aplikimit AL-T-2013/752;

Bazuar ne ngjashmerine e plote vizive dhe figurative/konceptuale, aplikimi AL-T- 2018/480 {...} shfaq qartesisht simboliken dhe skematiken vecanerisht te aplikimit AL- T-2015/258 dhe AL-T-2013/752, pamja e siperme e te cilit eshte identike me aplikimin nr.1082916, posacerisht avioni, predhat dhe ngjyra e kuqe, te cilat duken qartazi si simbole dhe elemente grafike te aplikimit AL-T-2015/258 dhe te aplikimit AL-T-2013/752. Nga te gjitha keto elemente shkelet hapur e drejta e meparshme e regjistrimit kombetar nr. 11992;

Mallrat e perfshira ne keto aplikime te {...} jane te njejta dhe bejne pjese ne te njejtin grup mallrash si ne regjistrimin "B52", nr. 11992 ne emer te {...};

Aplikimi {...} me AL-T-2018/480 krijon konfuzion te padiskutueshem midis konsumatoreve.

Me vendimin nr.prot 480/7 date 30.07.2019, Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale ka vendosur rrezimin e kerkeses.

Kunder ketij vendimi, shoqeria {...}sh.p.k ka paraqitur ankim prane Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, e cila me vendimin nr. 480/13, date 20.05.2020 ka vendosur: -Lenin ne fuqi te vendimit nr.480/7, date 30.07.2019 te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve...

Ne keto kushte, pala paditesi i eshte drejtuar gjykates duke pretenduar ne menyre te permbledhur se: - se pari: Paditesi legjitimohet ne ngritjen e kesaj padie, pasi ne kuptim te nenit 15, germa (a), te Ligjit nr. 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", te ndryshuar, kategorine e subjekteve qe pretendojne se i eshte cenuar nje e drejte apo nje interes i ligjshem nga nje veprim apo mosveprim i organit publik. se dyti: Paditesi eshte cenuar nga veprimet e organit publik konkretisht permes nxjerrjes se aktit administrativ Vendimi nr.480/13, date 20.05.2020 te Bordit te Apelit prane DPPI. se treti: Padia eshte ngritur brenda afatit 45 ditor nga njoftimi i vendimit te Bordit te Apelit objekt kundershtimi, te parashikuar nga ligji nr.9947, date 7.7.2008 "Per pronesine industriale", i ndryshuar. Me konkretisht paditesi eshte njoftuar per vendimin e Bordit te Apelit objekt kundershtimi me date 6.11.2020. Bazuar ne nenin 184/g te ligjit nr.9947, date 7.7.2008 "Per pronesine industriale", i ndryshuar, me titull "Padite kunder vendimeve te Bordit te Apelit" parashikohet se kunder nje vendimi te Bordit te Apelit mund te behet ankim ne gjykatën kompetente brenda 45 diteve nga dita kur eshte marre njoftim per vendimin. Si rrjedhoje, padia eshte ngritur brenda afatit te percaktuar ligjor. se katerti; Paditesi ka shteruar gjithashtu edhe rrugen e ankimit administrativ sipas kerkesave te nenit 16, te Ligjit nr. 49/2012.

-Vendimi i Bordit te Apelit objekt kundershtimi eshte ne kundershtim me te drejten e paditesit per te pasur nje vendim administrativ te arsyetuar. Me konkretisht, Bordi i Apelit nga 11 faqe vendim, vetem ne faqen 11 te tij, me dy paragrafe "arsyeton" vendimin e tij per lenien ne fuqi te vendimit te te Dhomes se Shqyrtimit te Kundershtimeve ne lidhje me marken {...}, nr. ALT/T2018-480. Ne 10 faqet e tjera te vendimit vetem pasqyrohen ne menyre te permbledhur pretendimet e paditesit, kundershtimet e {...}, si dhe pasqyrohet vendimi i Dhomes se Shqyrtimit te Kundershtimeve ne lidhje me marken {...}, nr. ALT/T2018-480. Vendimi i Bordit te Apelit objekt kundershtimi nuk shpjegon ne menyre te permbledhur rezultatin e hetimit administrativ dhe te vleresimit te provave, nuk shpjegon se pse nuk qendrojne pretendimet e paditesit te paraqitura ne ankimin administrativ drejtuar Bordit te Apelit, ne kundershtim me nenin 99 dhe 100 te Kodit te Procedurave Administrative. Ne ceshtjen objekt shqyrtimi Bordi i Apelit ka vepruar ne kundershtim me detyrimin e tij per ti dhene pergjigje me shkrim te gjitha pretendimeve qe paditesi ka ngritur. Kjo pervecse ne kundershtim me detyrimin e Bordit te Apelit per te arsyetuar aktet administrative qe nxjerr, por edhe ne kundershtim me detyrimin e tij per te vendosur per te gjitha ceshtjet e ngritura nga palet gjate procedures dhe qe nuk kane marre zgjidhje gjate tij, si dhe me detyrimin per te hetuar te gjitha faktet dhe vleresuar te gjitha rrethanat e nevojshme per zgjidhjen e feshtjes, detyrime keto te parashikuara nga nenet 48, 77, 90 te Kodit te Procedurave Administrative. Bordi i Apelit, duke mos marre ne konsiderate shpjegimet dhe provat e paraqitura nga paditesi, hetuar dhe vleresuar ne menyre gjithepershires, duke mos i dhene pergjigje ne menyre te shprehur te gjitha pretendimeve/shpjegimeve te paditesit, ka cenuar parimin e drejtesise, paanesise/barazise, objektivititetit dhe proporcionalitetit, si dhe ka vepruar ne kundershtim me detyrimin e tij per te ushtruar veprimtarine administrative ne menyre te ligjshme dhe transparente. Si rrjedhoje, Bordi i Apelit ka vepruar ne kundershtim me nenin 4, 5, 12, 13, 17 te Kodit te Procedurave Administrative.

-Vendimi i Bordit te Apelit objekt kundershtimi eshte dhene ne kundershtim me ligjin, kjo pasi aplikimi per regjistrimin e markes {...} nuk ka karakter dallues nga marka tashme e regjistruar B52 me nr.

Regjistrimi 11992, me pronar {...}. Aplikimi AL-T- 2018/480 {...} ka ngjashmeri te plote vizive dhe figurative/konceptuale, si dhe shfaq qartesisht simboliken dhe skematiken e markes tashme te regjistruar "B52", posacerisht avioni, predhat dhe ngjyra e kuqe, te cilat duken qartazi si simbole dhe elemente grafike te markes "B52". Nga te gjitha keto elemente shkelet hapur e drejta e meparshme e regjistrimit. Funkzioni kryesor i nje marke tregtare eshte te sherbeje si identifikues i burimit. Ne menyre qe ta kryeje kete qellim, marka duhet te kete vefori dalluese. Per kete arsye, dallueshmeria eshte kushti themelor per mbrojtjen e markes tregtare. Jo te gjitha marka tregtare kane veti te njejta dalluese, dhe si rrjedhoje, Bordi i Apelit duhet te kishte bere ne menyre te drejte matjen e nivelit te dallueshmerise. Nese vazhdohet me procedurat e regjistrimit te markes {...} perdoruesi i zakonshem nuk mund ta dalloje ate nga produkti tjetër "B52" i regjistruar si marke, per me teper qe kategoria e mallrave (te dyja jane pije energjike) ku do te vendosen markat eshte e njejta. Sa me siper, eshte ne kundërshtim ma parashikimet e meposhtme te ligjit nr. 9947, date 7.7.2008 "Per pronesine industriale", i ndryshuar. Duke qene qe markat tregtare kryejne funksionin e identifikimit te prejardhjes, qellimi kryesor i ligjit nr. 9947, date 7.7.2008 "Per pronesine industriale", i ndryshuar eshte pikerisht mbrojtja e konsumatoreve nga konfuzioni, ose mashtrimi lidhur me prejardhjen e mallrave dhe sherbimeve. Pronari i nje marke te regjistruar nuk ka nevojte te vertetoje konfuzionin aktual te krijuar nga perdorimi i markes identike ose te ngjashme, por vetem mundesine e krijimit te nje konfuzioni tek konsumatorët. Ne baze te vendimit te Gjykates Evropiane te Drejtesise (GjED) "Cannon, C- 39/97, 2008, ECR 1-5507": "Risku ne rastin kur popullata mund te besojte se mallrat dhe sherbimet ne fjale vijne nga e njejta ndermarrje ose, sido qe te jete rasti, nga ndermarrje ekonomike te nderlidhura, perbene mundesine e krijimit te konfuzionit sipas kuptimit te Nenit 5 (l)(b) te Direktives se Pare te Keshillit.

-Vendimi i Bordit te Apelit objekt kundërshtimi eshte dhene ne kundërshtim me ligjin, kjo pasi aplikimi per regjistrimin e markes {...} ka qartesi vizive dhe konceptuale, me marken tashme te regjistruar B52 me nr. Regjistrimi 11992, me pronar {...} dhe si rrjedhoje duhet te ishte refuzuar regjistrimi i saj bazuar ne parashikimet e ligjit nr. 9947, date 7.7.2008 "Per pronesine industriale", i ndryshuar. Bazuar ne jurisprudence e GjED-it, gjate vleresimit te ngjashmerise se mallrave dhe sherbimeve, organet administrative dhe gjykatat duhet te marrin parasysh faktoret ne vijim: "natyren e mallrave dhe te sherbimeve", "perceptimin e konsumatorit mesatar", faktin nese keto dy ndermarrje jane ne konkurrence me njera tjetren, apo jane ekonomike te nderlidhura. Gjate vleresimit te shkalles se ngjashmerise ne mes te markave, organet administrative dhe gjykatat duhet marrin parasysh faktoret ne vijim: "Shkallen e ngjashmerise vizuale (nepamje); Shkallen e ngjashmerise ne degjim", "shkallen e ngjashmerise konceptuale". Keshtu qe, ne

rastin e shfrytezimit te nje shenje identike, ose te ngjashme qe mund te krijojte konfuzion ne lidhje me nje marke tregtare sipas kuptimit te ligjit nr. 9947, date 7.7.2008 "Per pronesine industriale", i ndryshuar, organi administrativ duhet te refuzonte regjistrimin e saj. Persa me siper, rezulton se Marka 3ES shfaq ngjashmeri ne: Menyren e stilimit te gemes dhe shkronjave 3ES, pasi dukshem ato jane here ne menyre te tille qe te ngjasojne me marken B52: perdorimi i shkronjave te tjera grafike si ngjyra, avionic i cili qartazi gjan me avionin bombardues B2, si edhe predha qe leshohet prej tij.

Pala e paditur, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, ne menyre te permbledhur ka prapesuar se:- Kerkesa per regjistrimin e markes {...} (fjale e figure), me numer AL/T/2018/480 eshte publikuar ne Buletinin e Pronesise Industriale ne date 08/10/2018, ne perputhje me parashikimet e nenit 151 te Ligjit Nr.9947 date 07.07.2008, "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar. Kunder kesaj marke eshte depozituar, me date 26/10/2018, kerkesa per kundërshtimin e regjistrimit te saj nga shoqeria {...}. Dhoma per Shqyrtimin e Kundërshtimeve, mbeshtetur ne piken 1, te nenit 152, dhe shkronjes (b), te pikes 5, te nenit 143, te Ligjit Nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar, si dhe ne argumentat e paraqitura nga palet, ka perqendruar diskutimin ne tre ceshtje

kryesore:

- a) ngjashmerine mes markave;
- b) ngjashmerine mes mallrave per te cilat mbrohen markat ne konflikt;
- c) ekzistencen e mundesise qe te shkaktohet konfuzion tek konsumatori ose bashkelidhje mes markave per shkak te ngjashmerive te mesiperme.

-Ngjashmeria mes markave: Gjate analizes se ngjashmerise mes markave, dhoma ka marre ne konsiderate teresine e elementeve perberes te tyre dhe pershtypjen e pergjithshme qe shkaktojne ato tek konsumatori, por duke u fokusuar me teper ne elementet qe luajne rolin kryesor ne krijimin e karakterit dallues te markave. Ne kete kontekst, eshte analizuar e ngjashmerise mes tyre, per te vleresuar sakte rrezikun per konfuzion apo bashkelidhjen mes tyre nga konsumatori. Ne vijim te kesaj analize, Dhoma ka gjykuar se: Nga pikepamja vizuale, markat nuk jane te ngjashme per arsye se elementet perberes te tyre jane te ndryshme, pasi: Marka kundershuese "B52" perbehet nga ngjyrat: e kuqe; e zeze; e verdhe dhe e bardhe. Aplikimi per regjistrimin e markes {...} perbehet nga ngjyrat gri dhe e kuqe. Marka e kundershuar {...} konsiston nje avion te stilizuar dy-dimensional i permbysur, dhe te shkruajtur ne menyre vertikale shkrimin 3ES me ngjyre gri, ku midis shkronjes "E" dhe "S" ndodhet nje predhe e stilizuar me ngjyre te kuqe, kurse tek numri 3 ndodhet nje trekendesh i kuq i cili brenda permban nje stilizim te rrufes. Marka kundershuese me nr.regj. 11992, perbehet nga nje avion i stilizuar ne ngjyre te zeze i cili ka nje pamje shume realiste, i orientuar ne drejtim per ngjitje, ku si fond ka nje sferë te verdhe, poshte ketyre elementeve ndodhet e shkruajtur me ngjyre te kuqe B-52 energy drink. Elementet figurative te markave ne proces kundeshimi, jane vizualisht te ndryshme dhe nuk kane ngjashmeri ne menyren e stilizimit te tyre.

- Nga pikepamja fonetike apo degjimore, markat jane te ndryshme pasi, marka kundershuese shqiptohet "B pesedhete e dy" kurse marka e kundershuar shqiptohet "Tre ES", pra jane mjaftueshmerisht te ndryshme dhe lehtesisht te dallueshme nga konsumatori.

-Ne aspektin konceptual, duhet te analizohen sidomos elementet fjale te markave ne proces kundeshimi pasi konsumatori, ne rastin kur marka eshte kombinim i elementeve figurative me elementet fjale, ne pjesen dermuese te tyre e identifikon marken me emertimin ose pjesen fjale te saj. Ne kete rast jemi perpara dy ideve konceptuale krejt te ndryshme pasi konsumatori e ka krejtesisht te qarte dallimin midis konceptit "B pesedhete e dy" dhe konceptit "Tre ES". Konsumatori nuk mund te ngaterroje emertimin "B pesedhete e dy" me "Tre ES" e si pasoje nuk do te bente bashkelidhjen ndermjet markave. -Mallrat ku do te vendosen markat ne konflikt jane te ngjashme, por po te kemi parasysh analizen e mesiperme te ngjashmerise, per konsumatorin e te njejtave produkte, nuk ekziston mundesia e konfuzionit apo bashkelidhjes se origjines tregtare te mallrave, pasi markat e ketyre produkteve sic vleresuam kane dallueshmeri te mjaftueshme nga njera-tjetra.

-Mundesia e shkaktimit te konfuzionit: Duke u bazuar ne analizen e mesiperme te detajuar te ngjashmerise, Dhoma ka vleresuar se nuk ekziston nje ngjashmeri e mjaftueshme ndermjet markes se kundershuar dhe markes te meparshme, e tille qe te sjelle rrjedhimisht mundesine e konfuzionit ose e bashkelidhjes se tyre nga konsumatori. Mbi bazen e arsytimit te mesiperme, Dhoma per Shqyrtimin e Kundershimeve, me vendimin nr,480/7, date 30.07.2019, ka vendosur "Rrezimin e kundeshimit te regjistrimit te markes {...} me numer aplikimi AL/T/2018/480, me aplikant shoqerine "{...}", dhe vijimin e procedurave te regjistrimit te saj". Ne daten 12.12.2020, paditesi ka depozituar, kerkesen per apelim prane Bordit te Apelimit te DPPI me objekt: Apelim ndaj vendimit 480/7, date 30.07.2019, te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershimeve, ne lidhje me kundeshimin per regjistrimin e markes AL/T/2018/480. Bordi i Apelit, pasi ka marre ne shqyrtim kerkesen e shoqerise {...}, ka vleresuar se vendimi i Dhomes per Shqyrtimin e Kundershimeve, eshte marre ne kushtet kur marka me nr .AL/T/2018/480 {...} qe kerkon

te mbrohet nga shoqeria {...}, ka dallueshmeri per moskonfuzimin e konsumatorit ne treg me marken "B52" te shoqerise {...}, si nga ana konceptuale ku eshte krejtesisht e dallueshme marka 3ES me B52 si nga shkronjat, logoja, te cilat elementet perberes te tyre i kane te ndryshem. Gjithashtu dhe nga ana fonotike apo degjimore markat jane mjaftueshmerisht te ndryshme dhe lehtesisht te dallueshme nga konsumatori duke qene se marka kundershuese shqiptohet "B pesedhete e dy" kurse marka e kundershuar shqiptohet "Tre ES". Duke qene se marka qe kerkon te mbrohet ka mjaftueshem elemente qe e ben te dallueshme nga marka kundershuese, Bordi i Apelit ka vleresuar si te drejte vendimin e Dhomes per Shqyrtimin e Kundershimeve, i cili rezulton plotesisht i mbeshtetur ne dispozitat e ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", i ndryshuar. Me vendimin nr.480/13, date 20.05.2020, Bordi i Apelit ka vendosur "Lenien ne fuqi te vendimit nr. 480/7, date 30.07.2019 te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershimeve".

-Ne lidhje me pretendimin e paditesit se Bordi i Apelimit nuk ka arsyetuar vendimin dhe qe nuk ka marre ne konsiderate shpjegimet dhe provat e paraqitura, ky pretendim nuk qendron, pasi vendimi me nr.480/13, date 20.05.2020 eshte i arsyetuar dhe eshte plotesisht ne perputhje me nenin 99 dhe nenin 100 te Kodit te Procedurave Administrative. Gjithashtu, duke qene se BA ka vleresuar te drejte vendimin e Dhomes per Shqyrtimin e Kundershimeve, dhe te mbeshtetur ne dispozitat e ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", i ndryshuar, i ka qendruar po te njejtes linje arsytimi si Dhoma per Shqyrtimin e Kundershimeve. Vendimi nr.480/13, date 20.05.2020 i Bordit te Apelit eshte plotesisht i mbeshtetur dhe ne perputhje me ligjin nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", i ndryshuar dhe aplikimi i markes {...} eshte ne perputhje me nenin 140 dhe nenin 141 te ligjit, duke qene se mes markave nuk ngjashmeri te tille qe mund te shkaktoje konfuzion tek konsumatori ose bashkelidhje mes markave, dhe se elementet grafike qe permban marka {...} mundesoje dallueshmerine dhe jane te ndryshem nga ato te markes se paditesit. Per keto arsye, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, kerkon rrezimin e kerkesepadise, dhe lenin ne fuqi te vendimit nr. 480/7, date 30.07.2019 te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershimeve dhe te vendimit nr. 480/13, date 20.05.2020 te Bordit te Apelit. Pala e paditur, shoqeria {...}, ne menyre te permbledhur ka prapesuar se: - Pala e paditur {...} (ish {...}. pasi ka ndryshuar emrin), eshte thirur ne kete gjykim si pale e paditur. Nga analiza e padise rezulton se ne kete rast lidhur me kerkimin e 4-t te objektit te padise kjo gjykate nuk eshte kompetente, pasi nuk eshte nje mosmarreveshje administrative por nje mosmarreveshje me natyre civile e konkretisht tregtaree per me teper nuk ka shkak ligjor per kete kerkim. Si rrjedhim kjo padi me kete ndergjyqesi dhe objekt ose duhet te rregullohet ose duhet ti kthehet pales paditese pa veprime, pasi ka kerkime mikse ne kompetenca. Lidhur me kerkimet e tjera te cilat lidhen me anullimin e vendimit 480/13 dt. 20.05.2020 te Bordit te Apelimit dhe Vendimit nr. 480/7, dt. 30.07.2019 te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershimeve, pala e paditur {...} vlereson se padia eshte e pabazaur dhe si e tille duhet te rrezohet. Thelbi i pretendimit te paditesit eshte se aplikimi i pales se paditur {...} AL/T/2018/480 eshte ne pamje i ngjashem me marken nr. 11992 te pales paditese. Ky pretendim eshte thelbi i padise. Lidhur me kerkimet se akti administrativ eshte i paarsyetuar apo nuk i ka dhene pergjigje te gjitha pretendimeve ne vleresimn tone nuk qendron. Ne kete rast te gjitha provat, shpjegimet dhe qendrimet e paditesit jane analizuar dhe shqyrtuar. Lidhur me pretendimet per avionin dhe predhen sqarojme se keto elemente grafike si marke jane te mbrojtur me marken {...} me nr. regj. nderkombetar 1185591 e regjistruar dhe mbrojtur edhe ne Shqiperi. Ne kete kuptim pretendimi i pales paditese mund te shtrihet vetem ne geshtjen nese marka nr. 11992 B-52 e regjistruar nga pala paditese eshte e ngjashme apo krijon konfuzion me aplikimin AL/T/2018/480 3ES. Ne kete rast keto dy marka (fjale dhe imazhe) kane dallueshmeri shume te madhe, nuk krijoje asnje konfuzion dhe nuk kane asnje element te ngjashem.

Ne kete rast keto dy marka jane thelbesisht te dallueshme dhe nuk kane asnje ngjashmeri, si rrjedhim edhe vendimet e pales se paditur DPPI jane vendime te bazuara dhe si te tilla duhet te lihen ne fuqi. Ne kete rast keto marka nuk lidhen me njera tjetren ne asnje element, nuk kane ngjashmeri, nuk krijojne konfuzion dhe per me teper si grafikiqisht ashtu edhe ne fjale kane dallueshmeri mese te mjaftueshme. Lidhur me bazueshmerine e kerkimeve te paditesit, gjykata i referohet ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", si dhe vendimit unifikues nr.3 date 29.03.2012 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte. Ne vendimin unifikues nr.3 date 29.03.2012 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, eshte arsyetuar se: "Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte vleresojne se pergatitja dhe gjykimi e zgjidhja e geshtjes nuk mund te bazohet vetem mbi ate qe formalisht shkruhet ne pjesen hyrese te kerkesepadise e qe emertohen "objekti i padise" dhe "baza ligjore" e saj. Gjykata kur zgjidh mosmarreveshjen merr ne shqyrtim pretendimet e paditesit te cilat parashtrohen ne kerkesepadi si dhe gjate ushtrimit te se drejtave qe rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 e 185 te K.Pr.C. objekti i padise dhe shkaku i saj nuk permbliidhen domosdoshmerisht vetem ne pjesen hyrese te kerkesepadise. Gjykata ka detyrimin te vleresoje dhe te marre parasysh te gjitha permbajtjen e padise dhe te identifikojte kerkimet e paditesit, ne menyre qe te mund te jape nje vendim per to. Pala paditese ka te drejte te ngreje pretendime per mbrojtjen e te drejtave dhe interesave qe i njeh Kushtetuta apo ligji, ndersa gjykata, ne zbatim te parimit iura novit curia, analizon ligjerisht ne menyre te pavarur keto pretendime, pa u lidhur me percaktimin e paleve. Nese gjykata konstaton se pretendimet e paditesit, d.m.th. objekti i padise dhe shkaku i saj, gjejne mbrojtje ligjore atehere e pranon padine, ne rast te kundert padia rrezohet.

Ne kendveshtrim te ketij vendimi unifikues, duke marre parasysh permbajtjen e kerkesepadise, gjykata identifikon kerkimin e pales paditese. Ne thelb kerkimi i pales paditese ka te beje shfuqizimin e akteve administrativ, objekt gjykimi, per shkak te paligjshmerise se tyre, si dhe rregullimin e pasojave juridike qe kane prodhuar keto akte administrative.

Sic ka rezultuar, shoqeria {...} sh.p.k ka regjistruar marken me nr. Regjistrimi kombetar 11992, e regjistruar per mallra te klases 32 te klasifikimit te Nices, konkretisht "Pije jo-alkoolke, pije energjike, pije sportive". Ndersa shoqeria {...}. (tashme shoqeria {...}) ka paraqitur kerkesen me numer AL/T/2018/480, per regjistrimin e markes {...} prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesine Industriale. Kjo kerkesa eshte depozituar ne Drejtorine e Pergjithshme te Pronesine Industriale ne date 17.05.2018, dhe eshte publikuar ne Buletinin e Pronesine Industriale ne date 8.10.2018.

Ne zbatim te detyrimeve te sanksionuara te nenit 151 te ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", Drejtoria e Pergjithshme e Pronesine Industriale ka bere publikimin e ketij aplikimi.

Konkretisht ne piken 1 te kesaj dispozite parashikohet se:

1. DPPI-ja publikon te dhenat e aplikimit qe ploteson te gjitha kerkesat e parashikuara ne nenet 150 dhe 150/a ne buletin e radhes.
2. Te dhenat e aplikimit, qe botohen ne buletin e DPPM-se, parashikohen ne rregulloren perkatese.

Ne baze te nenit 151/a te ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", shoqeria {...} sh.p.k ka depozituar prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesine Industrial kerkesen per kundershkrimin e regjistrimit te markes me nr. Regjistrimi AL/T/2018/480.

Me vendimin nr.prot 480/7 date 30.07.2019, Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesine Industriale ka vendosur rrezimin e kerkeses.

Kunder ketij vendimi, shoqeria {...} sh.p.k ka paraqitur ankim prane Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesine Industriale, e cila me vendimin nr. 480/13,

date 20.05.2020 ka vendosur:

-Lenin ne fuqi te vendimit nr.480/7, date 30.07.2019 te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve. Ceshtja qe shtrohet per zgjidhje prane kesaj gjykate eshte nese veprimtaria administrative e pales se paditur Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industrial, eshte apo jo nje veprimtari administrative e ligjshme. Per kete ceshtje gjykata i referohet pikes 2 te nenit 17 te ligjit nr.49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", ne te cilen parashikohet: 2. Gjykata zgjidh mosmarrveshjet ne perputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera ne fuqi, qe jane te detyrueshme. Ajo ben nje cilesim te sakte te fakteve dhe veprimeve qe lidhen me mos marreveshjen, pa u lidhur me percaktimin qe mund te propozojne palet.

Nderkohe neni 37 i ligjit nr.49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative" percakton kufijte e shqyrtimit te geshtjes nga gjykata. Keshtu ne piken 1 te nenit 37 sanskionohet se gjykata shqyrton ligjshmerine e veprimit administrate qe kundershohet, ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe te situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohen e kryerjes se veprimit konkret administrativ. Konkretisht ne piken 1 te kesaj dispozite parashikohet se: 1. Gjykata shqyrton ligjshmerine e veprimit administrativ qe kundershohet, ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe te situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohen e kryerjes se veprimit konkret administrativ.

Ne kendveshtrim te nenit 152 dhe 153 te Ligjit nr.9947, date 07.07.2008 "Per pronesine intelektuale" dhe Kreut XI te V.K.M-se nr.1706, date 29.12.2008 "Per miratimin e Rregullores per regjistrimin e markave tregtare dhe te sherbimit", shoqeria {...} sh.p.k ka depozituar prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industrial kerkesen per kundershtimin e regjistrimit te markes me nr. Regjistrimi AL/T/2018/480.

Me vendimin nr.prot 480/7 date 30.07.2019, Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale ka vendosur rrezimin e kerkeses.

Kunder ketij vendimi, shoqeria {...}sh.p.k ka paraqitur ankim prane Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale.

Ne vijim, Bordi i apelimit i DPPM-se ka marre ne shqyrtim kundershtimin e aplikimit per regjistrim te markes me nr. Regjistrimi AL/T/2018/480, te paraqitur nga shoqeria {...} sh.p.k, duke njoftuar palen e interesuar shoqerine "{...}" per pjesmarrje ne proceduren e kundershthuar. Kjo e fundit ka paraqitur kundershtimet e saj prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale. Po keshtu Bordi e ka shqyrtuar kundershtimin brenda afatit ligjor dhe me pas ka marre vendimin, objekt gjykimi.

Nga teresia e kesaj veprimtarie administrative, gjykata vlereson se pala e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale ka respektuar standardet e procesit te rregullt ligjor, te cilat nuk jane te kufizuara vetem ne procesin gjyqesor, por edhe ne ate me karakter administrativ, kjo sipas vendimit nr.7 dt,27.02.2012 te Gjykes Kushtetuese, ne te cilin eshte arsyetuar se: 35. Ne kete aspekt, Gjykata Kushtetues, ne jurisprudencen e saj, e ka shtrire detyrimin per respektimin e te drejtes per nje proces te rregullt sa ne proceset gjyqesore aq edhe administrative. Ajo ka theksuar se "ne gdo rast Konventa Evropiane per te Drejtat e Njeriut vendos standardet e domosdoshme dhe garancite qe gdo shtet kontraktues duhet te siguroje per te realizuar nje proces te rregullt ligjor dhe jo rrethin e personave qe duhet te perfitojne prej saj. Ajo gmon se procesi i rregullt ligjor zbatohet per te gjitha konfliktet qe jane vendimtare per pozicionin juridik te nje personi, qofte ai edhe funksionar publik. Pra, Gjykata Kushtetuese e shikon pozicionin e funksionarit publik ne kendveshtrimin e garancive qe i siguron Kushtetuta, jurisprudenca e saj e deritanishme dhe fryma e Konventes Evropiane per te Drejtat e Njeriut. Gjykata Kushtetuese ka parasysh edhe dallimin qe ekziston ndermjet nenit 6 te Konventes

Evropiane per te Drejttat e Njeriut dhe nenit 42/1 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise. Ndersa ne Konvente parashikohet e drejta e individit per nje gjykim te drejte penal apo civil, ne nenin 42/1 te Kushtetutes dhe ne jurisprudencen tashme te konsoliduar te Gjykates Kushtetuese, e drejta e individit per nje proces te rregullt ligjor nuk eshte e kufizuar vetem ne procesin gjyqesor, por edhe ne ate me karakter disiplinor administrate (shih vendimin nr. 76, date 25.04.2002 te Gjykates Kushtetuese). Mbeshtetur, ne kete arsyetim, i cili ka forcen e ligjit (shih per kete vendimin nr.18, date 14.04.2015 te Gjykates Kushtetuese), gjykata cmon se, standardet e procesit te rregullt ligjor nuk jane te kufizuara vetem ne procesin gjyqesor, por edhe ne ate me karakter administrativ. Nga sa arsyetuar mesiper gjykata vlereson se Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale ka respektuar standartet e procesit te rregullt ligjor. Sa me siper gjykata gmon se ne aspektin procedural, pala e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale ka vepruar ne perputhje me proceduren e percaktuar ne ligjin Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", dhe per rrjedhoje ka nxjerre nje akt administrativ te ligjshem Po keshtu aktet administrative, objekt gjykimi, jane nxjerre ne perputhje me percaktimet e nenit 142 dhe 143 te ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale".

Konkretisht ne nenin 142 te ketij ligji parashikohet se:

1. Nje shenje nuk regjistrohet si marke ose nese regjistrohet, mund te shfuqizohet kur:

a) nuk ka karakter dallues;

b) perbehet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qe sherbejne ne treg per te treguar llojin, cilesine, sasine, qellimin, vleren, origjinen gjeografike ose kohen e prodhimit te mallrave apo te kryerjes se sherbimeve, ose per te treguar karakteristika te tjera te mallrave apo te sherbimeve;

c) perbehet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qe jane bere te zakonshem ne gjuhen e perditeshme apo qe jane kthyer ne praktika tregtare;

g) perbehet nga forma ose vija, te imponuara nga vete natyra e mallrave apo e sherbimeve dhe/ose forma apo linja thelbesore, per te permbushur nje rezultat teknik;

d) perbehet nga forma, qe u japin mallrave nje vlere thelbesore;

dh) perbehet nga elemente, qe cenojne interesin publik ose qe bien ne kundersiztim me vlerat morale apo rendin publik;

e) perbehet nga elemente, qe kane prirje te gorientojne publikun per natyren, cilesine, origjinen gjeografike ose tregtare te mallrave dhe/ose sherbimeve, qe ato kane per qellim te dallojne;

e) perbehet nga tregues gjeografike, per vererat ose pijet alkoolike, qe nuk e kane origjinen gjeografike nga vendet, qe tregohen ne keta tregues, edhe nese tregohet origjina e vertete e produkteve, ose treguesit gjeografike jane perkthyer apo shoqeruar me shprehje te tilla, si "lloji" "tipi" "stili" "imitimi" ose shprehje te ngjashme;

f) shfuqizuar;

g) perbehet nga:

i) emra shtetesh (te plote ose te shkurtuar);

ii) emblema shteterore, medalje, urdhra nderi;

iii) vula dhe shenja zyrtare te miratuara nga vendi;

iv) emblemat e organizatave te njohura nderkombetare ose shkurtimet e tyre;

v) simbolet fetare;

vi) flamujt kombetare;

gj) perbehet nga elemente, qe bien ne kundersiztim me nenin 6 te Konventes se Parisit, perveg kur autoritetet kompetente kane autorizuar perdorimin e tyre. h) nuk perben marke, sipas nenit 140 te ketij ligji;

i) permban ose perbehet nga nje emertim origjine ose nje tregues gjeografik, me efekt ne territorin e Republikes se Shqiperise, nese kerkesa per regjistrimin e markes eshte dorezuar pas dates se dorezimit te kerkeses per regjistrimin e emertimit te origjines ose treguesit gjeografik dhe me qellim mbrojtjen e tyre, te parashikuar ne legjislacionin, ne baze te te cilit jane regjistruar ato dhe qe kane lidhje me te njejtin lloj produktesh.

2. Nje shenje nuk perjashtohet nga regjistrimi si marke, ne perputhje me shkronjat "a", "b" e "c", te pikes 1, te ketij neni, ne qofte se marka, objekt shqyrtimi, ka fituar karakter dallues ne procesin e perdorimit perpara dates se aplikimit. Nje marke tregtare nuk mund te zhvleresohet per te njejtat arsye, nese, para dates se kerkeses per shfuqizim, per shkak te perdorimit te saj, ajo ka fituar karakter dallues.

Ndersa ne piken 2 te nenit 143 te ketij ligji parashikohet se:

2. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur:

- a) eshte e njejte me nje marke te meparshme dhe mallrat e sherbimet, per te cilat eshte aplikuar ose regjistruar ajo, jane identike me mallrat ose sherbimet, per te cilat eshte mbrojtur marka e meparshme;
- b) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njelloshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkaktimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme;

Nga intepretimi ad contrario qe i behet germes b) te pikes 2 te nenit 143 te ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" rezulton se, nje marke mund te regjistrohet nese nuk eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njelloshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkaktimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme. Ne rastin konkret, me te drejte Drejtoria e Pergjithshme te Pronesise Industriale ka rrezuar kundershimet e pales paditese per regjistrimin e kerkeses me numer AL/T/2018/480 per regjistrimin e markes {...}, pasi marka per te cilen eshte paraqitur kerkesa per regjistrim nuk eshte e njejte apo e ngjashme me sherbimet per te cilat eshte regjistruar marka e pales paditese. Ky fakt provohet dhe nga akti i ekspertimit grafik - dizanje, ne te cilin eshte konkluduar se: marka e rregjistruar nga shoqeria {...}sh.p.k dhe marka e regjistruar nga shoqeria "{...}", nuk kane logot as te njejta dhe as te ngjashme... jo, nuk egziston mundesia e shkaktimit te konfuzionit te konsumatorit...

Pra veprimtaria administrative e pales se paditur Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale gjen mbeshtetje ligjore ne nenin 142 dhe 143 te ligjit nr.9947/2008 "Per Pronesine Industriale".

Persa mesiper, gjykata vlereson se aktet administrative, objekt gjykimi, jane nxjerre ne perputhje me ligjin Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", dhe si te tille duhet te lihen ne fuqi. Per rrjedhoje kerkimet e pales paditese duhen

rrezuar.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kesaj ceshtje, gjykata arrin ne konkluzionin se padia e paraqitur prej paditesit duhet rrezuar si e pabazuar ne ligj dhe prova.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenet 40, 41,42 te ligjit nr. 49/2012 date 03.05.2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", nenet 306-310 te K.Pr.Civile

Veren:

Per keto arsye

.Baza Ligjore:

VENDOSI:

Vendosi:

•Rrezimin e padise.

•Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales paditese.

•Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar.

•U shpall sot me date 21.07.2021, Tirane.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

{...}